REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA DOGANORE

# RAPORT
# PËR PUNËN E DREJTORISË DOGANORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË VITIN 2008

Prill, 2009

## PËRMBAJTJA


I. EUROINTEGRIMET – UNIONI DOGANOR........................................................1

II. KAPACITETI INSTUTUCIONAL DHE ADMINISTRATIV ................................5

III. INTEGRITETI ........................................................................................16

IV. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I TREGTISË DHE TRANSPORTIT............20

V. TRANSPARENCA ........................................................................................24

VI. SHKATËRRIMI I KEQPËRDORIMIT TË DETYRËS ZYRTARE .....................25

VII. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE ..........................................................26

VIII. MBROJTJA E TË DREJATVE NGA PRONËSIA INTELEKTUALE .................33

IX. PAGESA E TË DHËNAVE IMPORTUESE ........................................................36

## I. EUROINTEGRIMI-UNIONI DOGANOR

1. **Harmonizimi me konventat tranzite të UE**
   Harmonizimi i Legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me konventat tranzite të UE dhe ndërlidhja kombëtare me sistemin informativ doganor të UE,paraqesin prioritet kryesor në fushën e doganës në procesin e eurointegrimeve.

   Sipas programit IPA 2008,Delegacion i Komisionit Evropian në 2008 ka realizuar procedurë tenderi për përzgjedhjen e ekspertëve nga UE të cilët së bashku me instutucionet kompetente të Republikës së Maqedonisë do të punojnë në analizimin e legjislacionit tonë tranzit dhe harmonizimin e tij me rregullat përkatëse të UE. Delegacioni i Komisioniot Evropian në Republikën e Maqedonisë në fund të vitit 2008 ka shpallur ashtu të quajtur listë të shkurtër të ofertuesve nga e cila duhet të zgjedhet ofertuesi më i mirë. Kontrata me ofertuesin më të mirë pritet të nënshkruhet në fillim të majit 2009. Drejtoria doganore në vitin 2008 ka përpunuar projekt verzion të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit doganor dhe Rregullores për zbatimin e Ligjit doganor të lidhur me vendosjen e deklaratës doganore në procedurën tranzite. Priten aktivitete intenzive në këtë fushë.

   **Në prill 2008 ka përfunduar procedura e tenderit për tre projekte të Drejtorisë doganore të financuar nga programi IPA 2007: 1) ndihma teknike për harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit me Asquis,posaçërisht në fushën e tranzitit ,2)ndihma teknike për përforcimin e kontrolleve kufitare 3) ndihmë teknike për përparimin e sistemit TI doganor nëpërmjet përgatitjes së specifikimit teknik për përpunimin e softevrit për lidhjen me sistemin informativ doganor të vendeve anëtare të Ue me atë nacional.**

2. **Lidhja me sistemin informativ doganor të UE**
   Në mes të vitit 2008 është përpunuar specifikimi teknik për zhvillim të sistemit nacional elektronik për përpunimin e deklaratave doganore (CDPS) i cili duhet ta kompenson më atë sistemin e vjetër (ASYCUDA) i cili do të përgjigjet në nevojat e tashme dhe të ardhshme të doganës dhe do të jet kontabil për interkoneksion me sistemet e UE dhe sistemin e ri transit kompjuteristik (NTCS). Në bazë të shpalljes së tenderit ndërkombëtar,në fund të vitit 2008 si ofertues më i volitshëm për përpunimin e sistemit elektronik për punimin e deklaratave doganore ësht zgjedhur Drejtoria doganore e Italisë dhe partnerët e tyre në konzerciumin ITA@MAC. Në rrjedh është përpunimi i softverit.

   Në suaza të komponentës TI nga programi IPA për 2007,në vitin 2008 është kompletuar zgjedhja e listës së shkurtër të ofertuesve për përgatitjen e specifikimit teknik për përpunimin e softverit i cili do ta lidh CDPS e ri nacional me sistemet përkatëse të UE.Delegacioni i Komisionit Evropian në Republikën e Maqedonisë në fund të vitit 2008 e shpalli listën e shkurtër të ofertuesve. Nënshkrimi i marrëveshjes me ofertuesin më të volitshëm pritet në fillim të muajit maj 2009.

   **Në nëntor 2008 përfaqësues të DG TAXUD kanë realizuar misionin e dytë monitorues TI në Drejtorinë e doganës me qëllim vërtetimin e plotësimit të kushteve “Acquis” të vendeve kandidatetë cilët gjatë hyrjes në UE duhet të jenë të aftë për lidhjen me sistemet tatimore dhe doganore të Bashkësisë Evropiane**

# I. EUROINTEGRIMI-UNIONI DOGANOR

Në programin IPA 2008 është siguruar financimi i ndihmës teknike për qasjen drejt Konventës për tranzit të përbashkët të UE,duke përfshirë përkrahjen për implementimin e NTCS dhe lidhjen me rrjetin komunikativ të përbashkët dhe sistemin interfejs të përbashkët – CCN/CSI.[1]

**Projekti IPA në 2008 përbëhet prej tre komponenteve:1) përkrahja në implementimin e NTCS,2)implementimi i NTCS a)akomodimi i softverit nacional për tranzit,b) zhvillimi i softverit dhe 3) implementimi i CCN/CSI.**

Në lidhje me plotësimin e kushteve për konekcion me tarifën e integruar doganore të UE-TARIC,tarifën informative të obliguar Evropiane EVTI,kuota,mbikëqyrje dhe regjistrimin doganor evropian të substancave kimike,Drejtoria doganore përgatiti projektin fishe për sigurimin e financimit nga programi IPA 2009.

3. **Vendosja e kornizave juridike për bartjen automatike e rregullave evropiane dhe harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit Maqedonas me Legjislacionin e UE në fushën e shpërndarjes së mallrave sipas tarifës,Qeveria e Republikës së Maqedonisë në korrik 2008 ka sjell Udhëzim për plotësimin e Udhëzimit për zbatimin e rregullave të Komisionit Evropian për renditjen e disa mallrave të caktuara në Nomenklaturën e kombinuar me çka është mundësuar transponimi i rregullave evropiane dhe harmonizimi i mëtutjeshëm i Legjislacionit Maqedonas me atë të UE.**

4. **Është ratifikuar Protokolli drejt Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim ndërmejt Republikës së Maqedonisë nga njëra anë dhe vendeve anëtare të Bashkësisë Evropiane nga ana tjetër. Në shtator 2008 është sjell Ligj për Ratifikimin drejt Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim ndërmejt Republikës së Maqedonisë nga njëra anë dhe vendeve anëtare të Bashkësisë Evropiane nga ana tjetër. Kyqja e Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Rumanisë në UE janë krijuar kushtet për implementimin e kumulimit dijagonal të prejardhjes me aplikimin e Republikës së Turqisë.**

5. **Janë ratifikuar ndryshimet e marrëveshjes për tregti të lirë ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Republikës së Maqedonisë. Në shtator 2008 janë nënshkruar ndryshimet e Protokollit 2 nga marrëveshja për tregti të lirë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë. Ndryshimet kanë për qëllim rrumbullaksimin e kornizës juridike me të cilën mallrat të prodhuara me lëndë të parë dhe materiale të përsëritura nga Turqia lirohen nga pagesa e doganës gjatë eksportit në vendet e UE,me çka rritet konkurenca e prodhimeve Maqedonase në UE dhe atraktiviteti për investime të huaj direkte në RM.**

6. **Përkrahja e UE për përfshirjen e Republikës së Maqedonisë në sistemin PEM për kumulim të prejardhjes së mallrave**
   Në mbledhjen e 9 të grupit punues të Komisionit Evropian për sistemin PEM për kumulim të prejardhjes së mallrave,UE ka dhënë përkrahje për përfshirjen e Republikës së Maqedonisë në konventën Regjionale për prejardhje preferenciale të mallrave në UE. Qeveria e Republikës së Maqedonisë e obligoi Ministrinë e

[1] Common Communication Network and Common System Interface

Ekonomisë që të inicoj bërjen e marrëveshjeve për tregti të lirë,përfshimisht edhe rregulla për kumulim të prejardhjes së mallrave,me shtetet e Mediteranit me të cilat Republika e Maqedonisë nuk ka lidhur marrëveshje të tilla.

7. **Ratifikimi i rekomandimit të Këshillit për bashkëpunim doganor të SCO në lidhje me ndryshimet e Konventës me të cilin krijohet Këshilli për bashkëpunim doganor.**
   Në korrik 2008 është sjell Ligj për ratifikimin e rekomandimit të Këshillit për bashkëpunim doganor të SCO me të cilin u pranua kërkesa për antarësim e bashkësive Evropiane,si union i përparuar doganor në Organizatën Botërore Doganore.
8. **Ratifikimi i Konventës së reviduar Kjoto**
   Në fund të vitit 2008 është miratuar Ligj për ratifikimin e Protokollit për ndryshime dhe plotësime të konventës Ndërkombëtare për thjeshtëzimin dhe harmonizimin të procedurave doganore,revidimi i konventës Kjoto,që paraqet harmonizim të mëtutjeshëm me Ascquis dhe pranimi i instrumenteve të SCO në pikpamje të sigurimit të balansit përkatës ndërmjet kontrollit dhe mbledhjes së të ardhurave nga njëra anë dhe lehtësimit të tregtisë nga ana tjetër.

9. **Është sjellë vendimi për harmonizimin dhe ndryshimin e Tarifës doganore për vitin 2009**
   Tarifa doganore,e cila është pjesë përbërëse e Ligjit për tarifë doganore,harmonizohet me obligimet e marra të cilat dalin me hyrjen e Republikës së Maqedonisë tek Organizata Tregtare Botërore,dhe ndryshon në pajtim me ndryshimet e nomenklaturës së kombinuar të Unionit Evropian,të shpallur në Gazetën zyrtare të Unionit Evropian nr. L 291 nga 30 nëntori 2008.

10. **Është ndryshuar dhe plotësuar Ligji për tarifa doganore**
    Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për tarifa doganore është bërë ndryshimi i shkallëve doganore MFN i 498 shkallëve doganore,si dhe ndarjen e disa numrave të caktuara në nivel nacional,në pajtim me rekomandimin e Këshillit për bashkëpunim doganor për ndarjen e nomenklaturave nacionale statistikore për nënnumrat tarifor për të lehtësuar mbledhjen dhe krahasimin e të dhënave të substanvace lëvizëse ndërkombëtare të kontrolluara me amandementet të Protokollit Montreal për substanca të cilët e prishin rrethimin ozonik (1 korrik 2006).

11. **Në janar 2008 kanë hyrë në fuqi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Doganor**
    Me këto ndryshime dhe plotësime është siguruar korniza juridike për sjelljen e konceptit të operatorit të autorizuar ekonomik,i cili është në drejtim të harmonizimit me legjislacionin nacional me Acquis communautaire,përkatësisht harmonizimi me ndryshimet e Ligjit doganor të Unionit Evropian 648/2005. Me ndryshimet dhe plotësimet janë caktuar kriteret për definimin e personave me rrezik më të madh,kushtet për marrjen e licencave doganore të dhënë më parë,lejet për përfaqësim,sjelljen dhe anulimin ose abrogimin e vendimeve nga fusha e doganës,me harmonizimin e njëkohëshëm të dispozitave përkatëse nga legjislacioni Evropian. Ndryshimet sigurojnë edhe harmonizimin e dispozitave në pjesën e kundërvajtjeve me Ligjin për kundërvajtje në bazë të së cilës Drejtoria doganore në janar 2008 ka filluar të shqiptoj dënime mandate për bërjen e kundlrvajtjeve doganore.

12. **Janë përgatitur ndryshime dhe plotësime të Udhëzimit për zbatimin e Ligjit Doganor**
    Ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit kanë për qëllim operacionalizimin e Ligjit doganor në pjesën e sjelljes së konceptit të operatorit të autorizuar ekonomik,si dhe decentralizimin e sjelljes së vendimeve për procedura doganore me efekt ekonomik (import për fisnikërim dhe deponim doganor) nga Drejtoria Qendrore në Shkup në degat doganore në tërë shtetin. Kjo e fundit ka për qëllim shkurtimin e kohës së nevojshme për dhënien e lejeve dhe ndryshimet e saja për kryerjen e punëve të importit për fisnikërim dhe deponim doganor.

13. **Vendosja e organizimit dhe aktivitetet e filluara për harmonizimin me udhëzimet doganore të reviduara të Komisionit Evropian** (Customs Blueprints)
    Në tremujorin 2008 Drejtoria doganore ka bërë vërtetimin dhe analizimin e shmangies në shikim të indikatorëve kyqe,në bazë të së cilëve është përgatitur plan aksionar për vitin 2009. Në çdo tremujor bëhet analizë përsëritëse të përparimit në shikim të plotësimit të indikatorëve kryesor me çka shqirtohet nevoja nga masat plotësuese për realizimin e tyre.

## II. KAPCITETI INSTUTUCIONAL DHE ADMINISTRATIV

1. **Vendosja e sistemit elektronik njësportel për dhënien e lejeve importuese, eksportuese dhe kuotave tarifore (Single Window/One Stop Shop)-EXIM**
   EXIM është në funksion prej nëntorit 2008 kuptohet qasja dhe përdorimi janë pa pagesë. Nëpërmjet internet portalit të administruar nga Drejtoria Doganore,operatorët ekonomik munden që prej kompjuterëve të tyre nga cilido vend në Republikën e Maqedonisë(është i nevojshëm sertifikati digjital) të kërkojnë dhe të marrin leje importuese dhe eksportuese dhe kuota tarifore nga 16 instutucionet qeveritare. Gjatë përgatitjes së EXIM :
   - Janë harmonizuar rregullat,formullaret dhe të dhënat(sipas standardeve të OON dhe UE) e të gjithave 16 instutucioneve të përfshira në EXIIM,
   - Është instaluar hardveri dhe pajisjet komunikative,
   - Është përgatitur softver (të finansuar nga USAID),
   - Janë bërë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për procedurën administartive të përgjithshme me të cilin parashihet mundësia për parashtrimin e kërkesave dhënien e vendimeve dhe komunikimit ndërmjet palëve në procedurën në formë elektronike,
   - Është ndryshuar dhe plotësuar Ligji për të dhëna në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik me të cilin në mes tjerash përcaktohen rregullat për pranimin dhe dërgimin e porosive elektronike,vlefshmëria e dokumenteve elektronike,
   - Është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për taksë administrative me të cilin mundësohet pagesa e taksës administrative për parashkresë dhe vendime në formë elektronike,pavarësisht nga shuma,të kryhet nga llogaria në llogari,ku pagesa mund të kyrehet në çd moment deri në dhënien e vendimit,
   - Në nëntor 2008 Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka sjellë Urdhëresë për vendosjen dhe mënyrën e përdorimit e sistemit informativ njësportel për import,eksport dhe tranzit,
   - Është vendosur help desk për asistimin e operatorëve ekonomik,
   - Në rrjedh është promovimi intenziv dhe njohja më detale e operatorëve ekonomik për përshtatshmëritë e sistemit,
   - Drejtoria Doganore ka sjell udhëzim për përdorimin e sistemit EXIM.

Në bashkëpunim me Odën Ekonomike,Drejtoria Doganore për operatorët ekonomik ka organizuar prezantim praktik të EXIM. Problem është kapaciteti i pamjaftueshëm kumunukativ (në rrjedh është tenderi për furnizimin e pajisjeve për rritjen e kapacitetit komunikativ) si dhe interesi jo i mjaftueshëm të përfaqësuesve doganor (në rrjedh janë promovimet dhe prezantimet).

**Instutucionet e përfaqësuara në EXIM**
- **Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë**
- **MPB –Enti për siguri publike**
- **Ministria e Ekonomisë**
- **Enti për metrologji**
- **Ministria e mjedisit jetësor dhe e planifikimit hapsinor**
- **Ministria për bujqësi,pylltari dhe ekonomi të ujrave**
- **Drejtoria e veterinës**
- **Drejtoria për farë dhe material mbjedhës**
- **Drejtoria Fitosanitare**
- **Inspektorati Shtetëror për bujqësi**
- **Enti për barna**
- **Inspektorati sanitar dhe shëndetësor shtetëror**
- **Drejtoria për ushqim**
- **Drejtoria për mbrojtjen e trashigimis kulturore**
- **Drejtoria për siguri rrezatimi**
- **Banka popullore e Republikës së Maqedonisë**

2. **Drejtoria doganore i ka marë kompetencat nga gjykatat për vendosjene e shkallës së parë sipas kundërvajtjeve devizore**
   Qëllimi është rritja e efikasitetit në sanksionimin e transportit jolegal të parave të huaja efektive dhe letrave me vlerë. Korniza juridike është siguruar me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punën me deviza në pjesët të cilat kanë të bëjnë me shumën e gjobave e cila shqiptohet për bërjen e kundërvajtjeve devizore,organi mbikëqyrës doganor,organi kompetent për udhëheqjen dhe shqiptimin e sanksioneve kundlrvajtës,si dhe afatin e parashkrimin për udhëheqjen e procedurës kundërvajtës.

3. **Drejtoria doganore nga Ndërrmarja Publike për udhëheqje me hapsirat banesore dhe afariste i ka ndërmarrë kompetencat për udhëheqjen dhe mirëmbajtjen e objekteve në vendkalimet kufitare për qarkullimin rrugor**
   
   Korniza juridike është siguruar me ndryshimet e Ligjit për Drejtorinë doganore e cila mundësoi që Drejtoria doganore nga shtatori 2008 të ndërrmer udhëheqjen,rregullimin dhe mirmbajtjen e objekteve në vendkalimet kufitare për qarkullimin rrugor. Janë bërë ndryshime përkatëse të akteve për organizimin e punës dhe sistematizimin e vendeve të punës,si dhe tarifave për kompenisme,është bërë regjistrimi i pasurisë së patundshme dhe të tundshme e cila merret bashkë me dokumentacionin e plotë. Drejtoria doganore nga Ndërmarrja publike për udhëheqje me hapsirta banesore dhe afariste ka marrë mbi 500 m2 hapsira afariste,tokë,terminale doganore dhe 204 punëtor. Me këtë ka filluar reforma e Ndërmarrjes publike për udhëheqje me hapësirat banesore dhe afariste,me zvogëlimin e njëkohëshëm të shpenzimeve dhe sigurimin e kushteve më të volitshme të operatorëve ekonomik dhe udhëtarëve.

4. **Në janar 2008 në vendkalimin kufitar Tabanovc oficialisht janë vendosur në fuksion 4 sisteme rentgen mobil për kontrollin e automjeteve me dimensione të mëdha dhe kontejnere**
   
   Me vendosjen e pajisjeve bashkëkohore janë vendosur standarde botërore për përshpejtimin dhe lehtësimin e qarkullimit të mallit,kontroll kualitet dhe i shpejtë i kamionëve

në shikim të përmbajtjes dhe llojit të mallit i cili transportohet,zbulimi i tregtisë të palejuar dhe kontrabandë e mallit të ndaluar dhe mall akciza,si dhe zbulimin e mallrave të palajmëruar nga cili do lloj. Puna me rentgenet mobil është procedurale me brojtje të plotë të nëpunësve doganor,mjetit transportues,ngarkimit,udhëtarëve dhe rrethimit njerëzor. Me qëllim që të sigurohet e theksuara më lartë,Drejtoria doganore në2008 ka sjell Rregullore për punën e Shërbimit për skener mobil,doracak për punë me skener mobil për kontroll të kontejnerëve dhe doracak për mbrojtje nga rrezatimi. Drejtoria doganore ka sjell edhe rregullore për punë dhe veprim të rastit të detektimit të nivelit të lartë të rrezatimit jonik,me të cilin rregullohet mënyra për detektimin e rrezatimit jonik,veprim në rast të zbulimit të burimit radiokativ dhe mbrojtjen e nëpunësve doganor.

**5. Vendosja e laboratorisë doganore**




Në gusht 2008,Drejtoria doganore dhe Instituti për kimi pranë Fakultetit Matematiko-natyror kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim afarist teknik. Sipas kësaj kontrate,laboratoria doganore punon në hapësirat e Institutit për kimi,ndërsa analizat i kryen një ekip i përbashkët profesional të përbërë nga kuadro profesionale hetuese nga Institti për kimi dhe të punësuarve në shërbimin për laboratori doganore pranë Drejtorisë doganore. Në hapësirat e Institutit për kimi është instaluar pajisje laboratorike të furnizuar me mjete nga programi CARDS 2005. Në rrjedh janë aktivitet për standardizim dhe akreditim të laboratorisë doganore. Drejtoria doganore ka sjell urdhëresë për mënyrën e e marrjes dhe analizimin e mostrave,me të cilin rregullohet mënyra e marrjes dhe dorëzimit të mostrave në analizë dhe caktimi i shpenzimeve për hulumtim. Qëllimi është kontrolli i tarifimit të drejtë dhe arkëtimi i plotë i të dhënave importuese. Drejtoria doganore në 2008 ka kryer 406 hulumtime laboratorike (234 në 2007,ndërsa 134 në 2006).

**6. Vendosja e sistemit të centralizuar kontrollues për video mbikëqyrje**

Sistemi mundëson video mbikëqyrje,inçizim dhe fotografim të territorit në të cilin Drejtoria doganore i kryen fuksionet e veta,në kohë të rregullt. Ai siguron përkrahje të aktiviteteve të Drejtorisë doganore për zbulimin dhe ndalimin e tregtisë së pa lejuar dhe kontraband të mallit,mbrojtjen e shëndetit të njerëzve,shkatërrimin e keqpërdorimit të autorizimeve zyrtare dhe moskryerjen me përgjegjësi të detyrve zyrtare,përshpejtimin e tregtisë dhe transportit dhe largimin efikas të ngecjeve eventuale,si dhe sigurimin e të punësuarve dhe pronën e Drejtorisë doganore.



Në të gjitha njësitë doganore janë vendosur kamera fikse dhe lëvizëse (gjithsejtë 240) të cilat kontrollohen nga ana e Repartit për koordinim dhe komunikim. Në bazë të analizave të rrezikut,informatave të zbuluara targitohet monitoringu u detyrueshëm,ndërsa kamerat inçizojnë 24 orë me 6 muaj rruajtje të shënimeve. Mundësi për qasje tek sistemi ka edhe përfaqësuesi i Drejtorisë doganore në qendrën koordinative nacionale. Drejtoria doganore ka sjell Urdhëresë për sistemin CCTV për videombikëqyrje,inçizim dhe transmision me të cilin rregullohet mënyra e punës,mbikëqyrja selektive të bazuar në analizë të rrezikut,autorizimet dhe qasja tek sistemi,si dhe mënyra e dhënies dhe shfrytëzimit të materialit të inçizuar.

7. **Vendosja e sistemit elektronik për njohjen automatike të targave të regjistrimit në Drejtorinë doganore**

   Në rajonin e njësive të brendshme dhe vendkalimeve kufitare doganore,Drejtoria doganore ka vendosur sistem për njohjen automatike e targave të regjistrimit në 132 lenta. Qëllimi kryesor i tij është kontrolli i rrjedhjes së automjeteve,zbulimin dhe ndalimin e tregtisë së palejuar dhe kontrabandës së mallrave. Është vendosur bazë të targave të inçizuara dhe softver për ndjekjen e tranzitit. Në rrjedh janë aktivitetet për mundësinë e Policisë kufitare që ta përdor këtë sistem për plotsëimin e bazave të tyre të të dhënave për nevojat e kontrollit të personave dhe automjeteve në vendkalimet kufitare. Me qëllim përdorimin e organizuar dhe sistematik të këtij sistemi,Drejtoria doganore ka përgatitur Udhëzim për punë me sistemin për njohjen automatike të targave të regjistrimit.

8. **Furnizimi i plombave moderne doganore**

   Me qëllim sigurimin më të madh të dërgesave dhe mbikëqyrjeve përkatëse doganore,Drejtoria doganore ka furnizuar lloj të ri të plombave doganore me numër të vetëm serik dhe evidentimin elektronik të mënyrës së dhënies së tyre. Me këto plomba doganor ndryshohen të tanishmet të cilat nuk sigurojn evidentimin e dhënies dhe lehtë keqpërdoren. Në rrjedh është testimi,ndërsa organizimi i vendosjes në funksion vijon në fillim të 2009,me sjelljen e procedurave të shkruara dhe evidentimin fuksional elektronik.



**9. Përforcimi i kapacitetit për mbikëqyrje doganore ndaj kufinjëve liqenore**

Drejtoria doganore ka furnizuar dy anije kontrolluese,i cili didikim është ndjekja dhe mbikëqyrja e kufijve të liqeneve të Prespës dhe Ohrit,si dhe zbulimin e kontrabandës. Në bazë të provimeve të dhëna,ekipe të posaçme të nëpunësve doganore kanë marrë leje për udhëheqjen me mjetet lundruese. Promovimi oficial u organizua me 14 prill,ditën e Doganës të Drejtorisë Doganore të RM.




**10. Uniforma të reja dhe pajisje për njësitë operative të Drejtorisë doganore**

Në shtator 2008 janë promovuar uniformat e reja doganore dhe pajiesjet teknike për punë të njësive operative të Drejtorisë doganore (buster-instrument për matjen e dendësisë e materialit me të cilin mund të zbulohen mallra të fshehura në shprastirat e automejtit,fiberskop-instrument me ndihmën e të cilit mund të futet në zbrastirat e automjetit,matës laserik të largësisë,pejxher për zbulimin e radiacionit dhe pajisje tjetër të sofistifikuar për zbulimin e mallrave të fshehur.



**11. Rritja e parkut qarkullues të ekipeve operative të Drejtorisë doganore**

Me 24 nëntor 2008 Ambasadori i SHBA në Maqedoni,Ministri i Financave dhe Drejtori i Drejtorisë Doganore kanë nënshkruar marrëveshje për donacion nga ana e Qeverisë të të SHBA. Të njëjtën ditë solemnisht u bë pranim dorëzimi i nëntë automjeteve për teren LADA NIVA,pajisje për zbulimin e aktiviteteve jolegale dhe kompjuter me vlerë të përgjithshme prej 280,000 dollar.



**12. Furnizimi i armëve moderne personale të njësive speciale të Drejtorisë doganore**

Në 2008 është furnizuar armë moderne personale për mbrojtjen e nëpunësve doganor në njësitë speciale të Drejtorisë doganore gjatë kryerjes së obligimeve punuese. Drejtoria doganore ka sjell edhe Udhëzim për mënyrën e ruajtjes

dhe përdorimin e armëve në Drejtorinë doganore,me të cilën rregullohet mënyra dhe kushtet e obligimit dhe rruajtjen e armëve,si dhe për përdorimin e tij.

**13. Furnizimi i qenëve të ri doganor**

Drejtoria doganore ka furnizuar 4 qenë të ri doganor. Me qëllim sigurimin e rruajtjen,dresimit dhe përdorimin,Drejtoria doganore ka sjell **Udhëzim për rruajtjen,trajnimin dhe shfrytëzimin e qenëve doganor për zbulimin e drogës,substancave psikotrope.**



**14. Futja e sistemit intern radio komunikativ**

Drejtoria doganore ka furnizuar dhe ka vendosur në fuksion sistemin intern radio komunikativ. Me qëllim sigurimin e qasjes së drejtë dhe udhëheqjes,Drejtoria doganore ka përgatitur Udhëzim për punë me sistemin radio komunikativ.

**15. Njësive operative të Drejtorisë doganore iu është siguruar qasje nga largësia drejt sistemeve TI të Drejtorisë doganore.**

Me qëllim rritjen e kapacitetit për zbulimin dhe ndalimin e tentimit për kontrabandë,njësive operative iu është mundësuar qasje patel nga largësia drejt sistemeve TI të drejtorisë doganore.

**16. Në përfundim janë punët për futjen e softverit për përpunimin e informatave zbuluese.**

Në bashkëpunim me Crown Agents,në rrjedh janë punët përfunduese për lëshimin në fuksion të aplikacionit TRIPS për përpunimin e informatave zbuluese,konfiskimeve,kundërvajtjeve,kontrolleve dhe të dhënave nga kontrolli. Janë realizuar trajnimet fillestare për administratorët dhe shfrytëzuesit të aplikacionit dhe është bërë testimi inicial.

**17. Përparimi i sistemit për kontroll të bazuar në analizë të rrezikut**

Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për kryerjen e kontrolleve selektive në punën doganore,me të cilin rregullohet qasja selektive të bazuar ndaj analizave të rrezikut,gjatë zbatimit të kontrolleve doganore. Qëllimi është rritja e efikasitetit nga kontrolli gjatë pengimit minimal të zhvillimit normal të procedurave doganore.

**18. Vendosja e qëllimeve kountitative në njësit doganore për kontroll dhe ndalimin e tregtisë jolegale**

Drejtoria doganore ka sjell udhëzim për vendosjen dhe ndjekjen e qëllimeve minimale kuantitative për ndalimin e tregtisë dhe për lehtësimin e tregtisë,të bazuar në analiz të rezikut. Udhëheqja me rrezikun ka për qëllim selektimin efikas dhe efektiv të dërgesave doganore ku ekziston rreziku më i madh se nuk janë në pajtueshmëri me dispozitat doganore dhe orientimi i resurseve të disponueshme tek këto dërgesa,ndërsa tregtisë ku nuk ekziston rreziku ti mundëson rrjedhje të lirë

me ndalim minimal. Në bazë të udhëzimit,për secilën njësi doganore janë vendosur targeta kountitative në 2009.

**19. Përparimi i sistemit të Drejtorisë doganore për punë me informatorë**
Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për punë me informatorë me të cilin rregullohen masat për punë të sigurtë me personat të cilët japin informata dhe mbrojtjen e tyre,qasjen standarde gjatë identifikimit të tyre,përgatitja dhe udhëheqja me qëllim sigurimin e rrjedhjes ekzistuese të informatave kualitete,si dhe procedurat për mbledhjen dhe rruajtjen e informatave nga informatorët dhe kushtet për dhënien e kompensimeve.

**20. Rregullimi i punës të Repartit për koordinim dhe komunikim**
Drejtoria doganore ka sjell udhëzim për punën e repartit për koordinim dhe komunikim me të cilin rregullohet mënyra e punës së RKK i cili punon 24 orë çdo ditë,ndërsa detyra kryesore e tyre është pranimi i informatave,analizat e para,vlerësimi dhe procesimi i tyr,dhënia e përkrahjes logjistike të doganierëve në teren dhe në njësitë doganore,si dhe udhëheqjen me videombikëqyrjet dhe sistemin për ndjekjen e automjetve të Drejtorisë doganore (GPS).

**21. Zhvillimi i projektit shkencor-hetimor RACWEBP**
Drejtoria doganore ka vazhduar me pjesëmarrje në projektin shkencor-hetimor RACWEB të financuar dhe nën patranazh të programit FP6. Qëllimi i projektit është rritja e efikasitetit dhe transparencës gjatë vërtetimit të rreziqeve në procedurat doganore,nëpërmjet definimit dhe miartimit të teknikave dhe zhvillimit të WEB serviseve informative,në administatat doganore të EU dhe vendet e Ballkanit Perendimor. Projeti është në fazë të integrimit,vendosja dhe testimi i vendimit të përgatitur dhe rrethimin e njohjeve shkencore hetimore gjatë përdorimit të teknikave të theksuara.

**22. Veprimi organizativ gjatë zbulimit të transportit jolegal të devizave**
Drejtoria doganore në 2008 ka sjell softver për evidentimin e të dhënave për futjen dhe nxjerren nga Republika e Maqedonisë deviza dhe marrjen automatike të të dhënave nga ana e Drejtorisë për ndalimin e larjes së parave. Drejtoria doganore ka sjell edhe doracak për përdorimin e aplikacionit për evidentimin e futjes dhe nxjerrjes së devizave,si dhe udhëzim për zbatimin e Ligjit për ndalimin e larjes së parave dhe dhurata tjera nga veprat ndëshkuese dhe finansim të terrorizmit me të cilin rregullohet mënyra e evidentimit të parave të futura dhe të nxjerra dhe letrave me vlerë nëpërmjet linjës doganore të RM.

**23. Participimi aktiv në qendrën nacionale koordinative**
Drejtoria doganore drejtpërsëdrejti,me oficer të vet për lidhje punon në qendrën nacionale koordinative si pjesë nga udhëheqja e integruar kufitare. Oficeri për lidhje i Drejtorisë doganore i cili ka qasje të plotë tek bazat e të dhënave të Drejtorisë doganore dhe te sistemi për videombikëqyrje.si dhe komunikim të vazhdueshëm me RKK.

**24. Ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për bashkëpunim dhe ndihmë reciproke për çështje të doganës (01.08.2008)**

Marrëveshja ka për qëllim përparimin e bashkëpunimit në zbulimin e tregtisë jolegale dhe krimit ekonomik,si dhe për këmbimin e diturisë dhe përvojës për lehtësimin e tregtisë dhe transportit.

25. **Vazhdimi i bashkëpunimit me JTI në fushën e ndalimit të tregtisë jolegale me duhan dhe prodhime duhani**
Në drejtim të vazhdimit të bashkëpunimit me bashkësinë e biznesit Drejtoria doganore ka nënshkruar **Aneks të Memorandumit për bashkëpunim me kompaninë e duhanit Japan Tabacco International**,me të cilin është paraparë vazhdimi i bashkëpunimit edhe për një vit.

26. **Kërkues i plotë funksional të lajmeve**
Kërkuesi i lajmeve përdoret për marrjen në paket të informatave mediatike të lidhur me punën doganore. Ky paket i nformatave mediatike distribuohet edhe tek të gjitha shërbimet në Drejtorinë doganore dhe në 2008 janë shpallur 70 botime.

27. **Vazhdon bashkëpunimi në fushën e luftës kundër krimit me instutucionet ndërkombëtare**
Në 2008 është intensivuar bashkëpunimi i Drejtorisë doganore me qendrën CEKI në Bukuresht,veçanarisht në pjesën e pjesëmarjes në të gjitha operacionet ndërkombëtare dhe këmbimit të informatave për konfiskime,si dhe informata tjera kundërzbuluese.

28. **Faza e dytë për harmonizimin me kornizën të standardeve të OBD për kontroll dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare.**
Në qershor 2007 është zbatuar misioni diagnostik i OBD për harmonizim të Drejtorisë doganore me kornizën e standardeve për lehtësimin e tregtisë,i cili raport është miratuar nga OBD në nëntor 2007. Njoftohet nga OBD se misioni i dytë diagnostik për përgatitjen e planit për realizimin e rekomandimeve nga misoni i parë diagnostik do të realizohet në pjesën e dytë të 2009.

29. **Mbarimi i fazës së parë nga pilot projekti për lehtësimin e tregtisë ndërkufitare ndërmjet Republikë së Bullgarisë,Republikës së Serbisë dhe Republikës së Maqedonisë**
Në suaza të pilot projektit për lehtësimin e tregtisë ndërkufitare ndërmjet Republikës së Maqedonisë,Republikës së Bulgarisë dhe Republikës së Serbisë,është bërë demonstrimi i teknologjisë TI dhe softverit për këmbimin elektronik të të dhënave në kohë reale. U tregua se si dogana,policia kufitare dhe instutucionet tjera komptente për kontrollin kufitar mund të pranojnë dokumente elektronike dhe të dhëna nga kompanitë,ti këmbejnë ndrëmetveti dhe ti këmbejnë me instutucionet kufitare të shteteve fqinjë të përfshirë në projektin. Në fazën e ardhshme projekti duhet të jep rekomandime për përshpejtimin e procedurave për import,eksport dhe transit ndërmjet shteteve të cilat janë të përfshirë,me ç'rast do të mundësohet bashkëpunim më efikas në regjion,nëpërmjet këmbimit elektronik të të dhënave për dërgesa dhe përdorimin e tyre për nevojat e analizave të rrezikut dhe kundërzbulim.

30. **Përgatitja e sistemit informativ elektronik të integruar të Drejtorisë doganore**
Në fund të 2008 ka përfunduar përgatitja e fazës së parë nga SII i Drejtorisë doganore. Në fillim të janarit 2008 këti vitë Drejtoria doganore ka filluar me implementimin e sistemit të përgatitur për arkivimin e dokumenteve dhe udhëheqjen me proceset punuese. Qëllimi i këtij projekti,i cili është në fazë të

pilot testimit është vendosja e sistemit për udhëheqje me dokumentet (eDMS) në Drejtorinë doganore. Faza e parë duhet të bëhet operative deri më 15.04.2009. Në bazë të metodologjive,procedurave dhe rregullave të caktuara puna me dokumentetet në SII përfshin:pranim të dokumenteve,formimi i lëndeve në Drejtorinë doganore,përpunimi i lëndëve dhe dokumenteve,verifikimi i lëndëve dhe dokumenteve,dërgimi i dokumenteve dhe arkivimi i dokumenteve në formë digjitale. Drejtoria doganore ka përgatitur Udhëzim për mënyrën e punës me sistemin elektronik për udhëheqjen me dokumentet,me të cilin përshkruhet mënyra e punës dhe rrjedhja e dokumenteve në njësitë organizative të Drejtorisë doganore nëpërmjet sistemit elektronik për udhëheqje me dokumente,dorëzimi i dokumenteve origjinale deri tek njësitë organizative,si dhe obligimet dhe kompetencat e të punësuarve. Në përgatitje është specifikimi teknik për fazën e dytë të SII.

**31. Vendosja e sistemit elektronik për evidentimin e kohës punuese**

Përveç vendosjes së sitemit elektronik për evidentimin e kohës punuese,Drejtoria doganore ka përgatitur edhe Udhëzim për përdorimin e sitemit për evidentimin dhe kontrollin e kohës punuese dhe hyrjes në hapsirat e Drejtorisë doganore,me të cilin përshkruhet mënyra dhe procedura për evidentimin e kohës punuese në Drejtorinë doganore,forma e kartelës për evidentimin e kohës punuese,obligimet e të punësuarve dhe udhëheqësve dhe kompetencat për veprim me qëllim evidentimin e drejtë të kohës punuese,kontrolli i përdorimit të kohës punuese nga ana e të punësuarve dhe kontrolli i hyrjes në hapësirat e Drejtorisë doganore. Në procedurë është furnizimi i bravëve magnetik për kontrollin e qasjes deri tek dhe lëvizja në hapësirat e Drejtorisë doganore.

**32. Vendosja e sistemit për pozicionimin global (GPS)**

GPS ka për qëllim që ta ndjek,analizon dhe koordinon lëvizjen e automjeteve në pronësi të Drejtorisë doganore në kohë reale. Është vendosur sistem të dispeçerëve të cilët e administrojnë GPS,me qëllim kontrollin e përdorimit efikas në destinacionin e duhur. Është përgatitur Udhëzim për përdorimin e GPS (të sjell në 2009).

**33. Rregullimi i procedurës për mbajtjen dhe marrjen e përkohëshme të mallrave**

Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për mënyrën e veprimit me mallrat e mbajtur dhe të marrë përkohësisht të hequr dorë në dobi të shtetit,me të cilin rregullohet mënyra e veprimit me mallrat e marra përkohësisht dhe me mallra të hequr dorë në dobi të shtetit,evidentimin e tyre,vendosja dhe rruajtja,shitja dhe shpërndarja e mjeteve të realizuar me shitjen.

**34. Vendosja e sistemit për planifikim dhe zbatimin e buxhetit të Drejtorisë doganore,furnizimet dhe investimet**

Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për përgatitjen dhe zbatimin e planit financiar,planit për investime dhe planit për furnizimet e Drejtorisë doganore me të cilin rregullohet organizimi,kompetencat,procedurat,dokumentet dhe informacionet për përpunimin e planit financiar,planit të investimeve dhe planit për furnizime të Drejtorisë doganore,formën e tyre,pëmbjatjen dhe mënyrën e ndjekjes së realizimit,ndërsa me qëllim vendosjen e kushteve për sigurimin me kohë dhe të drejtë financiar dhe mjeteve materiale për kryerje e fuksioneve të Drejtorisë doganore.

**35. Rregullimi i mënyrës së kryerjes të furnizimeve**
Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për kryerjen e furnizimeve me të cilin rregullohet mënyra dhe procedura për kryrejen e furnizimeve të mallrave,shërbime dhe punë,shpërndarrja e marrëveshjeve për furnizime publike,rrjedhja e dokumenteve gjatë kryerjes së furnizimeve,si dhe pranimin e tyre,evidentimin,rruajtjen dhe dhënien në përdorim te njësit organizative në Drejtorinë doganore.

**36. Rregullimi i mënyrës të kryerjes së udhëtimeve zyrtare**
Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për mënyrën dhe procedurën për lejimin e udhëtimeve zyrtare (pranimi në mbledhje,vizita pune,pjesëmarrja në seminare,trajnime,simpoziume) dhe pagesa e kompensimeve për shpenzimet udhëtuese ditore dhe shpenzimet tjera për udhëtimet zyrtare.

**37. Rregullimi i mënyrës të kryerjes së punës suplementare**
Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për mënyrën e realizimit të punës suplementare në Drejtorinë doganore,me të cilin rregullohet mënyra,arsyeja dhe kopetencat për caktimin e nevojës nga puna suplementare,si dhe mënyra e vërtetimit,informimit dhe kontrollit të punës së kryer suplementare.

**38. Rregullimi i mënyrës së likuidimit të dokumeteve financiare dhe mënyra e kryerjes së kontrollit financiar**
Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për mënyrën e likuidimit të dokumenteve financiare me të cilin rregullohet mënyra dhe kompetencat për likuidim dhe veprimi me dokumentet financiare për kryrejen e mallrave të furnizuar,shërbimeve dhe punëve në Drejtorinë doganore.

**39. Kapaciteti përforcues i Repartit për revizion të brendshëm**
Duke pasur parasysh numrin e madh të procedurave interne për punë dhe nevojën nga mbikëqyrja sistematike dhe permanente a do të zbatohen dhe si të njëjtat zbatohen,numri i përmbaruesve në Repartin për revizion të brendshëm është rritur në 3 persona,ndërsa në procedurë janë angazhuar edhe 2 revizor. Në 2008 janë bërë 11 revizione (9 në 2007) për të cilat janë përgatitur raporte me të cilën në pjesët e reviduara organizative iu është propozuar 40 rekomandime për përmirësimin e punës.

**40. Rregullimi i mënyrës së punës me materialet arkive dhe materialet e dukumentuara**
Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për mënyrën dhe teknikën për veprimin me materialin e dokumentuar dhe materialet arkive në punën arkive dhe zyre,i cili ka për qëllim dorëzimin e dokumenteve me kohë,ikjen e humbjes dhe prishjes së dokumenteve,si dhe lehtësimin e kërkimit të tyre.

**41. Sjellja e planit Aksional për punën e Drejtorisë doganore për 2009**
Plani aksional është sjell në pajtueshmëri me Strategjinë për zhvillim të Drejtorisë doganore për periudhën 2008-2010. Prioritetet e Drejtorisë doganore janë përqëndruar në pesë qëllime strategjike:
- korniza juridike – harmonizimi me rregullativën evropiane,
- arkëtimi efikas i të dhënave importuese dhe zbatimi i masave të politikës tregtare,

- mbrojtja e qytetarëve dhe lufta kundër krimit të organizuar,
- zbatimi efektiv i teknologjisë TKI,

**42. Vendi i parë për Drejtorinë doganore për udhëheqje të mirë**

Në suaza të projektit vlerësimi i potencialit për udhëheqje të mirë në Maqedoni i Fondacionit instituti shoqëria e hapur Maqedonia,me datë 03.07.2008 Drejtorisë doganore edhe oficialisht iu është dorëzuar mirënjohje për udhëheqje të mirë,në bazë të zgjedhjes të bërë me 27 mars 2008. Kriteret për zgjedhjen në konkurs kanë qenë vlerësimi i shkallës së profesionalizimit,efikasitetit,ekspertizmit dhe trajnimi i administratës,punësimi në administratë,qeverisja e së drejtës,transparenca,furnizimet publike,financimi menaxhues dhe kontrolli,ndërsa Drejtoria doganore është zgjedhur në kategorinë e organeve në administratës shtetërore.

**43. Iniciativa e Drejtorisë doganore për marrjen e sertifikatit për harmonizim me standardet ISO 9001:2000**

Plotësimi i kushteve sipas ISO 9001 është proces i filluar në Drejtorinë doganore i cili duhet të ketë përfundim me sertifikat nga ana e këshillit akreditues. Ky proces përbëhet nga aktivitetet të cilat Drejtoria doganore i relaizon në suaza të punës së vetë:vendosjes së procedurave të cilat i mbulojnë proceset kyqe në fushën e punës doganore,proceset kontrolluese për sigurimin e efikasitetit,rruajtja e të dhënave të nevojshme,përmirësimi i kushteve me aktivitetet korrektive ku është e nevojshme,kontrolli i rregullt ndaj proceseve vetiake dhe përbën kushte për zhvillim të vazhdueshëm.

**44. Mbledhje koordinative e donatorëve të Drejtorisë doganore**

Në qershor 2008 dhe në dhjetor 2008 u organizua mbledhja e tretë përkatësisht mbledhja e katërt koordinative donatore në fushën e punës doganore. Në mbledhje kanë marrë pjesë donatorët e përhershëm dhe potencial të cilët kontribuojnë për reformat në Drejtorinë doganore.

## III. INTEGRITETI

1. **Në Drejtorinë doganore është vendosur platforma e OBD për mësim elektronik**
   Misioni i OBD e instaloi platformën e vetë për mësim elektronik në Drejtorinë doganore. Janë realizuar trajnime të punësuarve për përdorimin e tij dhe është bërë plan për instalimin e modulit dhe sistemit në pajtim me strategjinë për trajnime dhe aftësimin profesional të nëpunësve doganor dhe plan Aksional dhe programi vjetor për trajnime. Në gjuhën Maqedone janë përkthyer modulet për kontroll kufitar,integritet,programi SAFE,dhe ndryshimet e sitemit të harmonizuar.

2. **Në korrik 2008 ka filluar shpallja e revistës mujore "CARINA"**
   Në revistën shpallen të rejat në punën doganore dhe të dhënat në fushat të cilat janë interesante për bashkësinë tregtare dhe biznesit. Revista CARINA botohet me qëllim rritjen e efikasitetit dhe transparencës në punën e Drejtorisë doganore,njoftimin e bashkësisë së biznesit me aktivitetet rrjedhëse dhe të planifikuara në punën doganore,shpalljen e informatave për nevojat e të gjithë të punësuarve në Drejtorinë doganore.

3. **Vendosja e bibliotekës doganore**
   Në mars 2008 është vendosur biblioteka doganore. Biblioteka doganore paraqet instrument nëpërmjet të cilit të gjithë të punësuarit në Drejtorinë doganore kanë qasje deri tek të gjithë materialet me të cilat disponon Drejtoria doganore,të cilat janë fituar na mënyra të ndryshme(blerje,donacione,etj). Nëpërmjet zhvillimit të bibliotekës do të bëhet kolekcionimi dhe regjistrimi i të gjitha materialeve,klasifikimi sitematik i tyre dhe evidentimi sipas lëmisë me të cilën ka të bëjë. Lista e librave,publikimeve,materilave video dhe audio është shpallur në faqen e intranetit të Drejtorisë doganore dhe është i kapshëm për përdorim nga ana e të gjithë të punësuarve.

4. **Nëpunësit doganor të ri kanë dhënë betimin solemn**
   Me 06 nëntor,për herë të parë pas sjelljes së Ligjit për Drejtorinë doganore,32 nëpunës doganor të punësuar në 2007,pas përfundimit me sukses të punës provuese dhe trajnimit profesional,kanë dhënë betimin me të cilin obligohen në respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Maqedonisë,zbatimin e drejtë të dispozitave doganore,repsektimi i dispozitave nga Kodi i sjelljes dhe rregullave për rend dhe disiplinë në Drejtorinë doganore si dhe në kryerjen e obligimeve të veta punuese në mënyrë profesionale,me nderë,dhe me përgjegjësi.

5. **Njësimi i statusit të nëpunësve shtetëror me atë të nëpunësve doganor**
   Një pjesë e vendeve të punës në Drejtorinë doganore kanë pasur status të nëpunësve shtetëror me të drejta jotëbarabarta me nëpunësit doganor dhe rrogën edhe pse i plotësojnë kushtet dhe karakteristikat e vendeve punës me status të nëpunësve doganor. Me ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtorinë doganore është barazuar statusi i nëpunësve shtetëror dhe doganor në Drejtorinë doganore.

6. **Rritja e pagës të nëpunësve doganor për 40%**
   Përreth rritjes për 10% në fund të vitit 2007,në gusht 2008 është realizuar baza ligjore për rritjen e pagës të nëpunësve doganor për 30%,ndërsa në shtator 2008 në suaza të rritjes gjenerale të pagave të shfrytëzuesve buxhetor,pagat e

nëpunësve doganor janë rritur për 10%. Për një vit pagat e nëpunësve doganor janë rritur për 55%.

7. **Në fazën përfundimtare janë aktivitetet për sigurimin e përfitimeve për pensionim të parakohëshëm për nëpunësit doganor**
   Ligji për Drejtorinë Doganore përmban korniza ligjore për sigurimin e përfitimeve të hershme të daljes në pension. Në përputhjet me kërkesat ligjore,një agjenci e autorizuar ka kryer shqyrtimin dhe analizimin dhe ka përgatitur një plan për mundësitë e sigurimit të përfitimeve të daljes në pension për disa vende pune. Në rrjedh është procedura e analizave dhe miratimit të elaboratit nga ana e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor dhe Ministrisë së punës dhe politikës sociale.

8. **Sjellja e Rregullave dhe kritereve për përzgjedhjen më të mirë të njësive të brendshme dhe kufinjëve.**
   Me qëllim që të forcohet integriteti i nëpunësve doganor,Drejtoria doganore ka sjell rregulla dhe kritere për përzgjedhjen më të mirë të kufirit dhe njësive të brendshme doganore e cila do të bëhet në bazë tremujore. Përzgjedhja e parë në bazë transparence është bërë për tremujorin qershor-shtator 2008,ndërsa pastaj për tremujorin tetor-dhjetor 2008. Zgjedhja është botuar në faqen e intranetit dhe të internetit. Në fund të 2008 të punësuarit e përzgjedhur si më të mirë në njësitë doganore u nderuan me shpërblim në shumë prej një rroge.

9. **Realizimi i programit për trajnime në Drejtorinë doganore 2008**
   Sipas programit vjetor për trajnime,në 2008 ka pasur 213 (171 në 2007) aktivitete të tilla si kurse trajnimi,seminare,takime pune,dhe prezantime. Në të kanë marrë pjesë 3418 pjesëmarrës (2322 në 2007) nga Drejtoria doganore. Në mesatare çdo i punësuar në Drejtorinë doganore në 2008 është 58 orë ose 4 ditë trajnim.

10. **Realizimi i trajnimeve dhe kurseve të planifikuara në kuadër të bashkëpunimit me Administratën Tatimore dhe Doganat e Mbretërisë së Holandës**
    Në qershor dhe dhjetor është mbajtur seanca e katërt dhe e pestë të Komitetit Drejtues. Vëmendje të veçantë i është kushtuar projekteve për rritjen e kapacitetit të kontrolleve dhe auditimit të Doganës,zbatimi i procedurave të thejshtëzuara doganore,vlera doganore dhe origjina e mallrave.

11. **Ngecje në aktivitetet për organizimin e SCO Qendrës Rajonale e trajnimit në Republikën e Maqedonisë**
    Fakulteti i Ekonomisë në Shkup dhe SCO nënshkruan Memorandum për bashkëpunim,dhe me mbështetjen e Qeverisë së Republikë së Maqedonisë deri tek SCO është dorëzuar iniciativë për hapjen e një Qendre Rajonale r trajnimeve në Shkup. Në përgatitje është plani për organizimin dhe punën e Qendrës. Pritet vendimi përfundimtar i SCO. Në tetor 2008 Drejtori i Drejtorisë Doganore në Bruksel u takua me Sekretarin e Pëgjithshëm të SCO,z. Kunio Mikurija. Në këtë takim u kërkua intensifikimi i aktiviteteve lidhur me fazën e dytë nga Korniza e standardeve për lehtësim dhe siguria e tregtisë globale dhe zbatimi i rekomandimeve nga programi Kolumbus 2.

Drejtoria doganore edhe një herë konfirmoi angazhimin e saj të fortë për hapjen e një SCO Qendër Rajonale trajnimi në Republikën e Maqedonisë.

**12. Me pajisjet nga Programi CARDS 2005 është furnizuar dhe është vendosur në funksion pajisjet për përkthym simultant.**
Pajisjet janë përdorur për rritjen e efikasitetit nga zbatimi i trajnimeve dhe llojeve tjera të aftësimit profesional të nëpunësve doganor.

**13. Vendi i dytë në turneun e 14 Botërorë të futbollit për persona të uniformuar**
Në periudhën prej 24-28 nëntor 2008 në Lomel të Belgjikës u mbajt turniri i 14 botërorë në futboll për persona të uniformuar,në të cilin Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë zuri vendin e dytë.

**14. Në Drejtorinë Doganore janë sjell Rregulla për rend dhe disiplinë**
Drejtoria doganore ka sjell Rregullore me të cilin përshkruhet rendi dhe disiplina në Drejtorinë doganore. Të punësuarit në Drejtorinë doganore janë të detyruar që të njohin,zbatojnë dhe ti respektojnë dispozitat e kësaj rregullore.

**15. Sjellja e planit aksional për ndalimin e korupsionit në Drejtorinë doganore.**
Në bashkëpunim me Crown Agents,Drejtoria Doganore ka sjell plan aksional të ri për ndalimin e korrupsionit i cili ka qëllim për të përmirësuar sistemin për veprimin preventiv dhe shkatërrimin e korrupsionit në Drejtorinë doganore. Ajo ka qenë në linjë me rekomandimet nga programi Shtetëror për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit,si dhe detyrimet Ligjore dhe parimet që dalin nga konventat ndëkombëtare.

**16. Rregullimi i mënyrës së punës të Sektorit për përgjegjësi profesionale**
Drejtoria Doganore ka sjell Udhëzim me të cilin rregullohet mënyra e veprimit të inspektorëve në Sektorin për përgjegjësi profesionale në lidhje me:
- zbulimi dhe vërtetimi i rasteve të sjelljes së paligjshme të zyrtarëve doganor në kryerjen e punëve doganore,
- autorizimet e personave zyrtar në kryerjen e detyrave të veta të veçanta dhe autorozimeve,
- kryerja e kontrollit të pajtueshmërisë me rregullat dhe cilësinë e punës në Shërbim,
- evidentimi,mbrojtjta e veçantë dhe përgjegjësia e punonjësve në Sektorin për përgjegjësi profesionale kur i kryejnë detyrat e tyre dhe obligimet.

**17. Drejtoria Doganore e mori përsipër administrimin e pasurive deklaruese për punonjësit e tyre nga Komisioni Shtetëror për parandalimin e Korrupsionit.**
Drejtoria doganore mori 812 pasuri deklaruese për nëpunësit doganor nga Komisioni Shtetëror për parandalimin e korrupsionit,në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit,me anën e të cilit është përcaktuar që obligimi për mbledhjen,regjistrimin dhe mbajtjen e pasurive deklaruese për personat zyrtar është përgjegjësi e instutucionit ku personi zyrtar është i punësuar. Zabtimi i këtij detyrimi është paraparë edhe në kontratat për punësim ku është theksuar se doganierët janë të obliguar të dorëzojnë deklarata të reja në çdo promovim të tyre. Në rrjedh janë aktivitetet për futjen e regjistrimit elektronik të të dhënave nga këto pasuri deklaruese,me kufizimin e rreptë. Regjistrimi i të dhënave nga pasurit deklaruese dio të përmban të dhëna për 1130 punonjës në Administratës doganore.

**18. Vendosja e sistemit të brendshëm kontrollues**

Në mars 2007,Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për sistemin e brendshëm kontrollues,e cila në përcaktimin e objektivave të kontrollit të brendshëm,mënyrën e identifikimit,analizën dhe vlerësimin e rreziqeve,si dhe procedurat e kontrollit të brendshëm dhe rolet e menaxhimit dhe punonjësit në Drejtorinë doganore. Sistemi i kontrollit të brendshëm të Drejtorisë doganore është përkufizuar si një proces i vazhdueshëm i cili përfshin të gjitha llojet tjera finaciare dhe kontrolle të cilat janë për të siguruar kushte për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të vëna,përdorimi ekonomik dhe efikas i burimeve,kontrolli adekuat i rreziqeve dhe rruajtjen e pasurive,besueshmëria dhe integriteti i informatave financiare dhe menaxhuese dhe harmonizimi me Ligjet,dhe rregullat si dhe me politikat,planet dhe rregulla tjera të brendshme dhe procedura. Vijojnë trajnime për implementimin e tij.

## IV. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I TREGTISË DHE TRANSPORTIT

1. **Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për tregti**
   Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për tregti është eliminuar nga procedura paradoganore detyrimi për kontroll të kryer dhe evidentimi e dokumenteve teknike kthyese-Atest nga Instituti për standardizim për mallra i parashikuar me vendim për klasifikimin e mallrave të formave të importit dhe eksportit. Gjithashtu,me ndryshimet e Ligjit për tregti është paraparë që gjatë importit të mallrave të dedikuar për shitje me pakicë nuk është e detyrueshme që ata të mbajnë deklaratë përkatëse dhe mësim për përdorimin e ambalazhit origjinal që të doganohet. Me këtë ndryshim mundësohet organet doganore të mirtaojnë import pa kërkuar çertifikatë të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Tregut,por inspektorati do ta kryhej kontrollin kur mallrat do të lëshohen në qarkullim të lirë në tregun e brendshëm.

2. **Shuma minimale e monedhave të huaja efektive dhe letrave me vlerë që mund lirisht të importohen dhe eksportohen në dhe nga Republika e Maqedonisë drejt standardeve të vendeve anëtare të UE dhe njëlloj për rezident dhe jorezident.**
   Ndryshimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për kushtet dhe shumën e monedhave të huaja efektive dhe çeqëve të cilat mund të importohen në ose të eksportohen nga Republika e Maqedonisë u bë i zbatueshëm nga 12 qershori 2008. Shuma minimale e cila mund të merret në /nga Republika e Maqedonisë pa detyrim për të deklaruar në autorritetet doganore është rritur nga 2.000 në 10.000 euro,dhe i harmonizuar me kërkesat për njoftim në përputhje me Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe i barabartë me personat vendas dhe të huaj. Drejtoria doganore ka vendosur sistem elektronik për njoftim të drejtorisë për ndalimin e larjes së parave për paraqitjen e futjes dhe nxerrjes së monedhave të huaja efektive dhe letrave me vlerë. Me ndryshimet do të ikin shumë raste të kundërvajtjeve devizore të cilat bëhen nga mosnjohja e mjaftueshme e ligjeve. Drejtoria doganore në bazë të informatave zbuluese,analiza të rrezikut dhe kontrollit të shoqërive tregtare,targeton dhe kontrollon mbartjen jolegale të parave të huaja efektive dhe letrave me vlerë të lidhur me tregtinë jolegale dhe larjes së parave. Në raportin periodik në 43 aksione janë konfiskuar 998.066 euro (raport i OBD).

3. **Hiqet tarifa doganore për përcjellje dhe për deponimin e mallrave në një magazinë doganore**
   Me ndryshimet e Rregullores për llojin dhe sasinë e tarifave doganore për shërbimet e bëra në procedurën doganore,janë hequr tarifat doganore për përcjelljen doganore dhe për deponimin në magazina doganore të organit doganor. Со измени на Правилникот за видот и износот на царинските надоместоци за направени услуги во царинската постапка, укинати се надоместоците за царинска придружба и за складирање во склад на царинскиот орган. Me zbatimin e këtyre ndryshimeve zvogëlohen shpenzimet për importin e disa llojeve të mallrave akcizë.

4. **Automjetet e pasagjerëve të pranuar si dhurata nga donatorë të huaj,të dedikuar për organet shtetërore,komunat,Qyteti i Shkupit dhe instutucionet publike janë liruar nga detyrimet e akcizave**
   Drejtoria doganore ka sjell ndryshime të Udhëzimit për zbatimin e Ligjit për akciza në punën doganore. Me ndryshimet është lehtësuar procedura për transferimin e pronësisë së automjeteve,kryesisht të dhuruara nga instutucionet e UE.

5. **Eliminimi i tarifave për përdorimin e shërbimeve të sistemit informativ doganor.**
   Nga 01.01.2008 janë hequr kompensimet për përdorimin e sistemit informativ doganor (shumë fikse për qasje dhe ndryshimin për përdorimin e sistemit).

6. **Eliminimi i kompensimit për peshim dhe zvogëlimi i kompensimeve për përdorimin e terminaleve shtetërore doganore në pikat kufitare për qarkullimin rrugor.**
   NP për menaxhimin me hapësirat banesore dhe afariste ka paguar reth 1.600 denarë kompensim për 72 orë qëndrim në terminalet doganore dhe peshim (tarifa ishte më e lartë për makinat e huaja). Me marrjen e kompetencave për menaxhim me objektet në pikat kufitare për qarkullim rrugor nga ana e Drejtorisë doganore,Ministri i Financave ka sjell ndryshime në Rregulloren për shumën e kompensimeve për shërbimet e kryera dhe shumën fillestare për të marrë me qira,lokalet afariste dhe hapsirat reklamuese në pikat kufitare,me të cilën është paraparë pagesa një tarife të vetme për hyrje dhe qëndrim të automjeteve dhe përdorim të terminalit në shumë prej 1.000 denarë.

7. **Vlera e mallrave jo-komerciale e cila mund të importohet pa pagesë detyrimet e importit u rritën nga 45 në 175 EUR**
   Është ndryshuar Rregullorja për kriteret më të ngushtë dhe mënyrën e zbatimit të përjashtimit nga detyrimet e importit,si dhe vlera,sasia dhe lloji apo qëllimi i mallrave të cilat mund të përjashtohen nga detyrimi importues. Në pajtim me këto ndryshime,pasagjerët vendas që kthehen nga shtetet e huaja janë përjashtuar nga pagesa e doganës për mallrat nga natyra jo-komerciale në vlerë prej 175 EUR në kundëvlerë denarë,në vend të vlerës 45 EUR sa ishte më parë,me ç'rast njëkohësisht është arritu harmonizimi me standardet e vendeve anëtare të UE.

8. **Komunikimi me komunitetin e Biznesit**
   Takime bilaterale dhe multilaterale janë realizuar me mbi 300 operator ekonomik,shoqeata dhe sindikata në disa qytete të Maqedonisë,ku u prezantuan aktivitetet aktuale dhe të ardhshme të Administratës doganore në lidhje me lehtësimin e importit dhe eksportit të mallrave në dhe nga territori i RM. Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit i theksuan problemet me të cilat ballafaqohen gjatë zbatimit të formaliteteve doganore dhe dhanë sugjerime të veta për zgjidhjen pra kapërcimin e këtyre problemeve.

9. **Përgatitja e sistemit elektronik për menaxhimin me procedurat e importit për fisnikërim**
   Softveri mundëson evidentimin elektronik të bartësve të autorizimeve për import për fisnikërim dhe monitoron garancit e tyre bankare. Sistemi nuk është ende në fuksion. Në rrjedh është furnizimi i lecencave për përkrahjen e sistemit,e cila do të pasohet nga instalimi i sistemit pa pagesë në zyrat e bartësve të autorizimeve si dhe trajnim për përdorimin e duhur për të gjithë përdoruesit.

10. **Përgatitja e Udhëzuesit për doganimin e mallrave 2009**
    Ky udhëzues është në dispozicion falas në faqen e internetit të Drejtorisë doganore. Objektivi i tij është për të lehtësuar procedurën doganore për zyrtarët dhe pjesëmarrësit tjerë në tregtinë ndërkombëtare. Përveç MFN normat

doganore,në të janë përfshirë edhe normat preferenciale,në përputhje me marrëveshjet për tregti të lirë,TVSH,akcizave dhe masat jo-tarifore të caktuara

**11. Përgatitjet për shitjen e decentralizuar të formularit EUR-1**
Shitja e formularëve EUR-1 kryhet vetëm në Drejtorinë Doganore në Shkup. Operatorët ekonomik patjetër të vinë në Shkup për të blerë formularë për sigurimin e dëshmive për origjinën proferenciale. Në 2008 kanë filluar përgatitjet organizative dhe softvere të cilët do të mundësojnë shitjen e këtyre formularëve edhe në të gjitha doganat në Republikën e Maqedonisë.

**12. Kriteret për pakësimin e mundur të garancive për borxhin potencial doganor të përshtatur me kushtet e ekonomisë Maqedonase**
Drejtoria doganore ka sjell ndryshime të Udhëzimeve për vlerësimin e kritereve për shumën e garancisë së përgjithshme,me të cilin kryhet zvogëlimi i kapitalit të nevojshëm minimal të kërkuesit,i nevojshëm për plotësimin e një nga kriteret për besueshmëri dhe stabilitet financiar,prej 1 milion euro në treqind mijë euro në kundërvlerë denarë. Në rrjedh është përgatitja për ndryshime sipas të cilës raporti i detyrueshëm për revizion i raporteve financiare ka të bëjë vetëm me operatorët ekonomik të cilat janë të detyruar me Ligj për shoqëri tregtare ta bëjnë një gjë të tillë. Këto ndryshime kanë për qëllim lehtësimin e punës dhe zvogëilimin e shpenzimeve,sidomos të kompanive mbajtës të autorizimeve për import për fisnikërim.

**13. Matja e kohës për zbatimin e importit dhe eksportit me procedurat e sistemit të OBD**
Në shtator 2008 Drejtoria doganore ka përgatitur studim për matjen e kohës të kalimit të mjeteve transportuese në 5 pika kufitare. Matja e kohës mesatare të kalimit në pikat kufitare është bërë duke pëdorur softver për matjen e kohës të zhvilluar nga ana e OBD,me ç'rast Republika e Maqedonisë u bë ndër vendet e para për të kryer këtë hulumtim. Rezultatet nga hulumtimi janë shumë të dobishme për sjelljen e masave për përmirësimin e efikasitetit në pikat kufitare në Republikën e Maqedonisë dhe bashkëpunimin me shërbimet tjera.

**14. Mundësimi i zbatimit të 24 orëve të procedurave doganore në pikat kufitare të cilat disponojnë infrastrukturë të përshtatshme**
Në vendkalimet kufitare Bogorodicë dhe Mexhitli (kufiri naqedonase-grek) doganimi eksportues kryhet 24 orë në ditë pa pagesë për transportuesit. Në pikat kufitare Bogorodicë (kufiri maqedonas-grek),Novo Sellë,Dellçevë dhe Deve Bair (kufiri bullgaro-maqedonas) dhe Bllacë(kufiri kosovo-maqedonas) procedura importuese-eksportuese zbatohet 24 orë. Problem është mosprania përkatëse të organeve inspektuese (inspeksioni veterinar dhe fitosanitar) dhe përfaqësuesve të autorizuar doganor. Avantazhet për operatorët ekonomik janë:1) eliminimi i nevojës dhe shpenzimeve nga deklarata transite doganore,2) eliminimi i nevojës dhe shpenzimeve për angazhimin e garancive bankare,3) elimini i nevojës nga pagesa e dyfishtë të taksave administrative, 4) eliminimi i nevojës nga qëndrimi i dyfisht dhe arkëtimi i i kompensimeve për shërbimet terminale,5) rritja e kapacitetit për ciklin e planifikimit të biznesit.

**15. Ndryshimet e njësive Doganore**
Njësia doganore Volkovë u mbyll në vitin 2008 dhe komptencat e saj ishin transferuar në njësinë Doganore Trubarevë. Në bazë të procedurave të

zbatuara për përmbledhjen e ofertave,u nënshkruan kontratat për shërbime për përdorimin e premisave për qëllim të mbikëqyrjes doganore në njësinë doganore Import terminalin (Fershped),njësinë doganore terminal eksportues(Deni Internacional në vend të Skopski pazarit) Njësia Doganore Veles (Makoil në vend të Brako),(Макоил, наместо Брако), Njësia doganore Shtip (Brilijant),Njësia doganore Manastir (Makoshped),Njësia Doganore Tetovë (Teteks),Njësia doganore Strumicë (ETA). Njësitë për të cilat nuk ka kontrata të tilla ende janë doganat Kvadarci,Kumanovë,Prilep dhe Ohër.

**16. Ngecje në implementimin e projektit TTFSE II në pjesën e përmirësimit të kalimit kufitar të pasagjerëve Bllacë drejt Kosovës**

Përgatitja e dokumentacionit të plotë për aktivimin e tenderit për furnizimin e shërbimeve për ndërtimin e vendkalimit kuiftar Bllacë. Problem është çështja e pazgjedhur të tokës.

**17. Licensimi**

Në 2008 operatorët ekonomik kanë qenë të interesuar në marrjen e autorizimeve për përpunim të brendshëm. Interesimi i firmave që aplikojnë për autorizime për procedurat e thjeshtëzura doganore ende mbetet shumë i ulët. Megjithatë,në vitin 2008 interesi për marrjen e informacionit tarifor të detyrueshëm është rritur. Në vitin 2008 Drejtoria Doganore ka filluar të zbatoj mbikëqyrjen sistematike dhe kontrollin e bartësve të autorizimeve të doganave për përfaqësim,e cila rezultoi ne 3 raste autorizimet të anulohen për shkak të parregullsive të themeluara në operacionet e kompanive,bartës të këtyre autorizimeve.

| Lloji i lejes | Numri i lejeve të dhëna | |
|---|---|---|
| | 2008 | 2007 |
| Përfaqësimi doganor | 25 | 22 |
| Procedura me efekt ekonomik | 213 | 226 |
| Pranues i autorizuar | 9 | 8 |
| Doganim lokal | 32 | 27 |
| Eksportues i autorizuar | 8 | 1 |
| Informacione të detyruara doganore | 174 | 99 |

**18. Vëllimi i punës**

Në 2008 janë përpunuar gjithsejtë 468 mijë deklarata doganore,ku për 11,2% është më shumë në krahasim me 2007. Nga këta,269 mijë janë deklarata importuese doganore,duke qenë me 9% më shumë se në vitin 2007,kur janë përpunuar 253 mijë deklarata importuese doganore. 200 mijë deklarata eksportuese janë proceduar në vitin 2008,duke qenë për 17% më shumë në krahasim me vitin 2007. Nuk kan ndodhur ndryshime thelbësore në numrin e deklaratave të përpunuara në rrugën hekurudhore,postare dhe të trafikut ajror në vitin 2008. Në vitin 2008 666 mijë automjete kanë kaluar kufinjtë e Republikës së Maqedonisë duke qenë për 5%më shumë krahasuar me vitin 2007.

## V. TRANSPARENCA

1. **Rregullimi i mënyrës dhe procedurave për publikimin e informatave,artikujve,njoftimeve në faqen e internetit dhe intranet portalit**
   Miratimi i Udhëzimit për mënyrën dhe procedurën e publikimit të përmbajtjeve në faqen e internetit dhe intranet portalin e Drejtorisë doganore,i cili ka për qëllim promovimin e mëtutjeshëm të lajmërimeve të gjitha palët e interesuara,zyrtarët doganor dhe pjesëmarrësit në procedurat.

2. **Rregullimi i mënyrës së qasjes tek sistemi informatik**
   Miratimi i Udhëzimit për mënyrën dhe kushteve për qasje në sistemin TIK të Drejtorisë doganore,me të cilin rregullohet mënyra,procedura,kompetencat dhe përgjegjësit për hapjen dhe mbylljen e qasjes së përdoruesve të subjekteve të brendshëm dhe të jashtëm,si dhe niveli i privilegjeve në sistemin informativ të Drejtorisë doganore,mënyra e përdorimit të tij,vlefshmëria dhe besueshmëria e informatave.

3. **Miratimi i Udhëzimit për veprimin me formularët e plotësuar nga ditari i qytetarëve të Drejtorisë Doganore**
   Me udhëzimin rregullohet vendosja e kutive për ditarin e qytetarëve,veprimi me formularet e plotësuara si dhe publikimin e ditarit të qytetarëve në faqën e internetit të Drejtorisë doganore.

4. **Bashkëpunimi me Instutucionet Arsimore**
   Në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim afat-gjatë ndërmjet Drejtorisë doganore dhe Fakultetit për Turizëm dhe ushqim,dogana dhe shpedicioni-Ohër,në korrik 2008 organizoi praktikë vere për student të rregullt nga dogana dhe shpedicioni. Mësimin praktik e përfunduan 39 student të rregullt të shpërndarë në 14 njësi doganore për doganim të mallrave. Në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë në Shkup 10 studentë morën pjesë në trajnimin praktik të shpërndarë nëpër njësi doganore. Me punën praktike studentët u njoftuan për së afërmi me kompetencat dhe fushëveprimin e punës të Drejorisë doganore.

5. **Në faqen oficiale të internetit të Drejtorisë doganore në vitin 2008 janë shpallur 700 informata në gjuhën Maqedonase,Angleze dhe Shqipe**
   Me qëllim përmirësimin e transparencës në informimin e të punësuarve dhe publikut më të gjërë,në 2008 janë publikuar 220 njoftime në intranet portalin të Drejtorisë doganore ndërsa në faqën e internetit janë publikuar 700 informata në gjuhën Maqedonase,Angleze dhe Shqipe. Në 2008 në faqen e internetit dhe portalin e intranetit vazhdimisht publikohen propozime për udhëzime të reja dhe drejtime,me qëllim që të ofrojë që publiku më i gjërë të jep mendimet e veta dhe sugjerimet para miratimit të udhëzimeve dhe drejtimet me të cilat më detalisht rregullohet mënyra e zbatimit të formaliteteve doganore.

6. **Hapja e linjës telefonike doganore**
   Linja telefonike e hapur doganore (197) është një nga metodat për mbledhjen e informacioneve për të gjitha llojet e parregullta. Duke qenë në një sistem të avancuar,ai bën te mundur që çdo thirrje të regjistrohet dhe inçizohet. Në 2008 janë regjistruar 98.859 thirrje (për 24% më shumë në krahasim me 2007) ose në mesatare 279 në ditë,nga të cilat 498 thirrje me përmbajtje të dobishme. Nga këto 251 iu referuan sjelljes joprofesionale të nëpunësve doganor ndërsa 247 të mbetura për paraqitjen e tentimeve për tregti të paligjshme.

## VI. SHKATËRRIMI I KEQPËRDORIMIT TË DETYRËS ZYRTARE

### 1. Inspektimet e brendshme

Në 2008 janë kryer 46 inspektime në të gjitha njësitë organizativetë Drejtorisë doganore (në krahasim me 33 në vitin 2007,përkatësisht 22 në vitin 2006). Nga tabela e paraqitur mund të shihet se në vitin 2008 vëmendje të veçantë iu është kushtuar rregullsisë së punës në Drejtorinë doganore,me 17 inspektime të kryera në krahasim me vitin 2007 kur janë kryer vetëm 2 inspektime dhe veçanarisht në vitin 2006 kur nuk ka pasur asnjë inspeksion. Në bazë të gjetjeve nga këto inspektime,vazhdohet me hetimet e brendshme për shqyrtimin e ekzistencës së përgjegjësisë disiplinore, si dhe me ndërmarrjen e masave hetuese dhe hetimeve kundër kryerësve të kundërvajtjeve doganore dhe veprave penale.

| | Numri i inspekcioneve | | |
|---|---|---|---|
| Pjesa organizative | 2008 | 2007 | 2006 |
| Drejtoria Qendrore | 17 | 2 | |
| Dogana e Shkupit | 19 | 10 | 16 |
| Dogana e Kumanovës | 2 | 1 | 1 |
| Dogana e Shtipit | 8 | 9 | 2 |
| Dogana e Manastirit | 5 | 6 | 2 |
| Dogana e Gjevgjelisë | 5 | 5 | 1 |
| Gjithsejtë | 46 | 33 | 22 |

### 2. Hetimet e brendshme

Në 2008 janë realizuar 140 hetime të brendshme (krahasuar me 240 në vitin 2007),ku në 70 raste (në krahasim me 87 në vitin 2007) janë konstatuar shkelje disiplinore dhe parregullsi. Ndryshe nga 2007 dhe 2006 kur nuk ka pasur asnjë inspektim të brendshëm në Drejtorinë qendrore,në vitin 2008 janë kryer 20 hetime të brendshme.

| | Numri i hetimeve | | |
|---|---|---|---|
| Pjesa organizative | 2008 | 2007 | 2006 |
| Drejtoria Qendrore | 20 | | |
| Dogana e Shkupit | 33 | 65 | 23 |
| Dogana e Kumanovës | 22 | 29 | 17 |
| Dogana e Shtipit | 18 | 57 | 7 |
| Dogana e Manastirit | 25 | 27 | 14 |
| Dogana e Gjevgjelisë | 22 | 62 | 10 |
| Gjithsejtë | 140 | 240 | 71 |

### 3. Procedurat Disiplinore

Në 2008 janë ngritur 93 procedura disiplinore kundër një numri të punonjësve (89 në 2007) për caktimin e përgjegjësisë për shkeljen e rendit dhe disiplinës në punë,në bazë të së cilëve në 46 raste u vendos masa disiplinore shkarkim nga puna,në 35 raste zyrtarët u gjobitën,ndërsa në 17 raste është konstatuar se nuk ekziston përgjegjësi disiplinore. Në bazë të kryerjes së veprave penale në vitin 2008 në 4 raste është sjell vendim për suspendimin e nëpunësve doganor.

Në bazë të procedurave parahetuese të realizuara,në 2008 kundër 122 nëpunës doganor deri tek prokuroritë publike kompetente janë ngritur kallëzime për shkak ekzistimit të dyshimit për bërjen e veprës penale keqpërdorim të pozitës dhe

kompetencave zyrtare.

Për 43 nëpunës doganor të cilët e kanë ndërprerrë punën me Drejtorinë doganore,deri tek Komisioni shtetëror për ndalimin e korrupsionit janë dorëzuar informacione me qëllim që të pritet dorëzimi i listës anketuese nga ana e tyre.

## VII. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

### 1. Pengimi i kontrabandës dhe rruajtja e përkohëshme e mallrave

Në 2008 Njësitë mobile të Administratës doganore kanë kryer kontrolle detale në 4.883 kamionë,(4,391 në 2007),908 autobusëve (633 në 2007),dhe 5,251 automjeteve(6378 në 2007). Bashkë me kontrollet në njësitë e brendshme dhe kufitare doganore,për tentimet e konstatuara për transit dhe import jolegal,përkohësisht janë mbajtur një sasi të madhe të mallrave të ndryshëm.

Përveç të natyrës parandaluese,skenerat e lëvizshëm kanë pasur rol të rëndësishëm në zbulimin e tregtisë së paligjshme (66 pako heroin me peshë prej të përgjithshme prej 32 kg,1,3 kg kokainë,23 pako nga 500 gram morfium-bazë,40.000 EUR,32,5 kilogram stoli argjendi dhe 920 gram stoli arri,183 copë ikona,2880 litra verë,11003 copë prodhime të ndryshme konditore etj.

Në veprimtaritë e veta për parandalimin e tregtisë së paligjshme Drejtoria doganore ngushtë bashkëpunon me Policinë Kufitare,Policinë Financiare,Drejtoria për parandalimin e larjes së parave,Drejtoria e të hyrave publike,Drejtoria e veterinarisë,Drejtoria për ushqim,Drejtoria për siguri rrezatimi dhe organe tjera shtetërore. Për çdo ditë përdoren shërbimet e sistemit për marrjen automatike të të dhënave nga Regjistri Qendror për persona juridik dhe Depoziti Qendror të dhëna për pagesë të cilat i ndërmerr softveri për pagesë.

Në 2008 Drejtoria doganore ka koordinuar dhe organizuar në nivel nacional 4 operacione ndërkombëtare:1) SHADOW 3 ndjekja e transporteve me cigare,2) Herricane 2 dhe FAIR PLAY lufta kundër tregtisë me mallra e cila shkel të drejtat e pronësisë intelektuale,3) ATAMAN,PROTEUS dhe Drug Stop për luftën kundër tregtisë me drogë dhe 4) SEZAM projekt për konfiskimin e parave.

Bashkëpunimi me RILO,brenda OBD është intensifikuar nga të dhënat e kontributit në CEN bazën e të dhënave,vazhdon bashkëpunimi me ZKA Info Ballkan që përfshin shkëmbimin e të dhënave për konfiskimin e drogës dhe të dhëna e mundshme në kontrabndën e drogës.

Konfiskimet më të rëndësishme janë:

- **Duhan dhe prodhime duhani: 10,12 tonë duhan të coptuar imët dhe 946.305 copë cigare**
- **Pije alkoolike:2.800 litra**



- **Ushqim dhe prodhime ushqimore:94,7 tonë**



- **Armë dhe municione:15.288 copë**




- **Kozmetikë dekorative dhe prodhime higjienike:237.465 copë**



- Prodhime tekstili,veshje dhe shtesa mode: 224.515 copë



- Atlete dhe lloje tjera të mbathjeve:17.757palë




- Medikamente dhe produkte mjekësore: 125.062 copë



- **Aparate elektrike,kompjutor,pajisje dhe pjesë kompjuterike**: 156.920 copë



- **Maqina,allate dhe pjesë:** 38.884 copë




- **Bizhuteri dhe stoli :** 472 mijë copë



- **Pjesë për automobila:** 11.977 copë



- **Syza për diell dhe syza me dioptri:** 7.555 copë



- **Lodra për fëmijë:** 7.280 copë



- **Ora dore:** 944 copë



- **Stoli,pajisje kuzhine dhe elemente për amvisëri: 181.991 copë**
- **Çanta,rripa,kuleta,dhe valixhe udhëtues: 11.512 copë**
- **Pëlhurë,lëkurë dhe tepisona: 28.111 м²**
- **Lule dhe bimë: 13.100 copë**
- **Mobilje: 5.370 copë**
- **Arri dhe stoli arri: 1.402 gramë**
- **Objekte arkeologjike dhe etnologjike: 22 copë nga shekulli 19 dhe 20**

Për të konfiskuar mallra për të cilat procedurat ligjore kanë përfunduar (përfundimi i procedurave administrative dhe gjyqësore),Drejtoria doganore në vitin 2008 ka organizuar dhe mbajtur 9 ankande publike për shitje,16 shpallje për shitje në rrugë të mbledhjes së ofertave,dhe 2 shitje me negociata të menjëhershme,ku është shitur mall me vlerë rreth 1 milion denarë. Në periudhën e njëjtë,Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi 46 vendime për dhurim të mallit të konfiskuar organeve shtetërore dhe organizatave humanitare. Mallrat të cilat nuk mund të shitet apo dhuruar janë shkatërruar në pajtim me dispozitat doganore. Në vitin 2008 janë shkatëruar 43 tonë duhan të copëtuar,2.475 kartone cigare,225 puro,267 litra alkool,12.520 kg mish derri të ngrirë,dhe 3.200 kg mallra tjerë të ndryshëm (prodhime ushqimore,pjesë për makina,barna etj).

2. **Trafikimi i paligjshëm i parave të gatshëm**
   Drejtoria Doganore në vitin 2008 ka zbuluar disa përpjekje për të importuar dhe eksportuar monedha të huaja të padeklaruara mbi limitin e lejuar,ku përkohësisht ka mbajtur monedha të ndryshme të huaja në kundërvlerë 998 mijë euro (gjegjësisht edhe 170 mijë dollar amerikan të falsifikuar).



3. **Tregtia e palejuar me narkotikë**



Brenda vitit 2008 Drejtoria doganore ka zbuluar dhe mori pjesë në zbulimin e disa përpjekjeve në tregtinë e aligjshme të narkotikëve,ku në mesin e gjërave të tjera janë konfiskuar edhe 12 kg morfinë,37,7 kg heroinë,49 gramë farë kanabis. Në rastin e ditës ndërkombëtare doganore (26 janar)i cili në vitin 2008 është shpallur si ditë kundër luftës së tregtisë së paligjshme me drogë dhe substancave psikotropike, OBD dhjetë nëpunësve doganor nga Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë iu shpërndau Certifikata për kontribut të jashtëzakonshëm në zbulimin e tregtisë së paligjshme me drogë dhe substancave psikotrope.

4. **Kontrolli i kompanive tregtare**

Në vitin 2008 Drejtoria doganore deri tek shërbimet e huaja doganore ka dërguar 215 kërkesa për verifikimin e vlerave të treguara në fatura dhe 208 kërkesa kontrollin e 643 prova të origjinës (në 2007 janë dërguar 153 kërkesa për verifikimin e vlerave të treguara në fatura dhe 220 kërkesa për verifikim të 452 prova të origjinës).

Janë kryer 418 kontrolle të bartësve të autorizimeve për import të fisnikëruar dhe deponim doganor (316 në 2007)në bazë të së cilave janë shqipëtuar 206 gjoba mandate ,ndërsa në 19 raste u hiqen autorizimet (6 raste në 2007).

Janë kryer 244 kontrolle të kompanive tregtare (187 në 2007) në bazë të së cilës janë inicuar 1.189 procedura për pagimin plotësues të borxhit doganor

5. **Zbulimi i kundërvajtjeve doganore**

Në komisionin për vendosje sipas kundërvajtjes në Drejtorinë Doganore në vitin 2008 janë pranuar 3.643 raste për bërjen e kundërvajtjeve doganore,nga të cilat 1.250 janë marrë nga gjykatat të cilat shpallur si jo kompetente për veprim,496 kërkesa nga MPB, dhe 1897 nga njësitë e administratës doganore. Në vitin 2008 janë zgjidhur 863 lëndë ku është shqiptuar gjobë në shumë prej 3.1 milion denarë. Në bazë të kryerjes së kundërvajtjeve doganore në vitin 2008 janë shqiptuar 437 dënime mandate në shumë të përgjithshme prej 5,05 milion denarë.

6. **Zbulimi i veprave penale doganore**

Në bazë të hetimeve të kryera,Drejtoria doganore në 2008 deri tek prokuroritë publike ka dorëzuar 164 vepra penale,kundër 81 personave juridik dhe 209 kundër personave fizik. Edhe në vitin 2008 pjesa më e madhe nga kallëzimeve penale kanë të bëjnë me bërjen e veprave penale,mashtrim,kontrabandë dhe qarkullim të palejuar me mallrat akcizë. Në vitin 2008 janë zbuluar një numër i konsiderueshëm të dokumenteve të falsifikuara,në bazë të së cilave deri tek prokuroritë publike kompetente janë dorëzuar 20 kallëzime penale (në 2007 janë zbuluar 7 raste të tilla)

| Vepra penale | 2007 | 2008 |
|---|---|---|
| Futja e materieve të rrezikshme | 0 | 1 |
| Shmangie nga tatimi | 10 | 5 |
| Ligji për akciza dhe paraqitje të rrejshme | 0 | 1 |
| Vjedhje | 0 | 1 |
| Përpunimi i palejuar,rruajtja dhe | 1 | 1 |
| Kontrabanda | 35 | 38 |
| Prodhim i paligjshëm | 2 | 1 |
| Prodhim i paoutorizuar dhe qarkullim me | 3 | 2 |
| Qarkullim me mallra akcizë pa banderole | 55 | 35 |
| Ndalimi i personave zyrtar në kryerjen e | 0 | 1 |
| Transporti me mallrat akcizë nga | 1 | 3 |
| Falsifikimi dhe përdorimi i dokumenteve | 7 | 20 |
| Falsifikimi i parave | 0 | 1 |
| Mashtrim doganor | 48 | 51 |
| Gjithsejtë | 163 | 164 |

**7. Mbrojtja e shëndetit dhe mjedisit jetësor**

Në 2008 Drejtoria doganore maksimalisht ka mobilizuar kapacitetet e saj për detektimin e burimeve radioaktive. Në 2008 Drejtoria doganore e RM në hyrje për në RM ka zbuluar 6 raste të dukshme të nivelit të lartë të rrezatimit radioaktiv mbi nivelin e lejuar dhe në bashkëpunim me Drejtorinë për Siguri radiacioni ka reaguar dhe janë ndërmarrë masa për eliminimin e pasojave të dëmshme.



# VII. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

1. **Fushatë për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale**
   Në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërrisë së Holandës dhe Ministrisë së Kulturës,në janar 2008 Drejtoria doganore ka filluar një fushatë për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale. Qëllimi i fushatës është të ngrejë ndërgjegjësinë e publikut për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale,luftës kundër falsifikimeve dhe mënyrën e njohjes së tyre.




2. **Memorandum për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale**
   Me 06 shkurt 2008,Ministria e Kulturës,Drejtoria Doganore,Shoqata për mbrojtjen e të drejtave muzikore dhe autoriale ZAMP, Oda Ekonomike kanë nënshkruar memorandum për bashkëpunim për realizimin e masave doganore. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është që nëpërmjet këmbimit të informatave,aksioneve të përbashkëta,trajnimeve të vazhdueshme për njohjen e kopjeve pirate,ngritjen e procedurave standarde për veprim në rastet e shkeljes së të drejtave autoriale dhe të afërta gjatë zbatimit të masave doganore,të përmirësohet mirkuptimi,njohja dhe zbulimi i mallrave të përpunuar pa pajtueshmëri të bartësit të së drejtave autoriale etj.

3. **Rritja e numrit të kërkesave të regjistruara për mbrojtjen e pronësisë intelektuale**
   Numri i kërkesave të regjistruara të kompanive për marrjen e masave doganore për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale në fund të vitit 2008 ishte 199 (80 kërkesa të reja dhe 119 vazhdimësi të afatit nga viti i kaluar) në krahasim me 146 (103 kërkesa të reja dhe 43 vazhdimësi të afatit nga viti i kaluar) në fund të vitit 2007.

4. **Sipas raportit të OBD në vitin 2007 10 vend sipas numrit të aksioneve**
   Në bazë të raportit vjetor të OBD dhe IPR raporti i 2007,Maqedonia është në vendin e 10 në botë sipas realizimit të numrit të veprimeve për mbrojtjen e e shkeljeve të pronësisë intelektuale. Gjegjësishtë,gjatë vitit 2007 Drejtoria doganore ka realizuar 325 sekuestrime të mallrave e cila cënon të drejtat e pronësisë intelektuale.

5. **Rezultatet**
   Drejtoria doganore në 2008 ka ndërhyrë në 173 raste të arsyeshme dyshimi lidhur me importin dhe transitin e mallrave që shkelin të drejta nga pronësia intelektuale (krahasuar me 325 në 2007). Numri i zvogëluar i intervenimeve është zvogëluar parasëgjithash për shkak rënies së numrit të përpjekjeve për import dhe veçanarisht transitit si rezultat i kontrolleve rigoroze,si dhe për shkak përforcimit të masave nga vendet fqionje,veçanarisht nga ana e Republikës së Bullgarisë si dhe nga mungesa e interesimit nga disa përfaqësues të markave tregtare të

reagojnë nëse bëeht fjalë për sasia të vogla të mallrave për të cilat ka dyshime të arsyeshme për shkelje të së drejtave nga pronësia intelektuale.

Në bazë të veprimeve të realizuara,përkohësisht janë konfiskuar 983.301 copë,20.217 kg,10.826 litra dhe 550 metra mallra të falsifikuar duke përfshirë:

- 130.560 copë artikuj kozmetike




- 18.000 kg pluhur larës




- 7.441 copë parfume,ujë tualeti dhe deoderns



- 16.473 copë pjesë për celularë




- 51.028 copë veshje




- 62.662 copë pajisje sportive dhe mbathje



- 34.240 copë pastë dhëmbësh



- 17.434 copë syza për diell,këllëf për syza për diell,çanta,rripa,kuleta,ora,shkrepsa dhe pajisje tjera për përdorim personal
- 6.997 copë pjesë për automobila
- 656.450 copë mallra tjerë



Në bazë të Ligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,ndërsa pës mbarimit të procedurës për verifikimin e falsifikimit dhe shkeljes së të drejtave nga pronësia intelektuale,Drejtoria Doganore në 2008 u ndihmoi bartësve të markave tregtare në kryerjen e procedurave për shkatërrimin e 229.705 copë mallra të falsifikuara.

## IX.PAGESA E TË DHËNAVE DOGANORE

1. **Në 2008 ka vazhduar procesi i leberalizimit,në pajtim me** përgjegjësitë që dalin nga Protokolli për pranimin e Republikës së Maqedonisë në Organizatën Botërore Tregtare,kur normat e detyrës u reduktuan për një mesatare prej 1.05%(norma mesatare për 2008 është 9.78%,ndërsa për 2007 është 9.29%) dhe zvogëlimi vjetor i normave doganore sipas tabelave kohore nga Marrëveshja për tregti të lirë (për liberalizimin e plotë të prodhimeve industriale është realizuar me disa vende)**.**

2. **Pagesa e gjithsejtë e të dhënave importuese në 2008 është për 22% më shumë në krahasim me vitin 2007**
   Në emër të të dhënave të përgjithshme janë paguar 51 miliardë denarë ku për 22% është më shumë në krahasim me 2007.

   Në emër të doganës dh etë dhënave tjera doganore janë paguar 6,4 miliardë denarë duke qenë pak më pak në krahasim me shumën e paguar në 2007 si rezultat i tendencës të zvogëlimit të normave dhe liberalizimin në marrëveshjet për tregti të lirë dhe importit të reduktuar në tre mujorin e fundit. Kjo konfirmon edhe faktin se deklaratat e cila pagesë është siguruar me garanci për pagesë të shtyrë të birxhit doganor në 2008 arrin 35% nga numri i përgjithshëm të deklaratave,ndërsa në 2007 përqindja e deklaratave me anulimin e pagesës është 25% nga numri i përgjithshëm të deklaratave të dorëzuara,ose në shumë absolute vlera e deklaratave të siguruara me garanci për pagesë të shtyrë është për 11% më lartë në vitin 2008 në krahasim me 2007,si dhe vlera e importit të mallrave e cila shkallë e doganës sipas Ligjit për tarifa doganor është 0 është për 25% më e lartë në 2008 në krahasim me 2007. Kjo u konfirmua nga analizat e njëzet titujve tarifore të cilët më së shumti kanë marrë pjesë në importin gjatë tetorit 2008,të cilët kanë marrë pjesë me 38% në vlerën e përgjithshme të importit.

   Në emër të TVSH,Drejtoria doganore ka paguar 43,3 miliardë denarë ku për 26 % më shumë në krahasim me 2007.

   Në emër të akcizave Drejtoria doganore ka paguar rreth 1 miliardë denarë ku për 10% më shumë në krahasim me 2007.

   Në bazë të kompnesimeve  për buxhetin qendror Drejtoria doganore ka paguar 272 milion denarë ku për 59% më shumë nga 2007.

   Në bazë të të ardhurave sipas tarifave për shërbimet e dhëna nga Drejtoria doganore janë paguar 115,6milion denarë,ku për 58% më shumë në krahasim me 2007,ndërsa ka të bëjë me pagesën e kompensimeve për shërbimet terminale të ndërmarra nga NP për menaxhimin me banesat dhe hapsirat afariste.